

VENDIM
Nr.75, datë 21.2.2007

**PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJEVE TË BESNIK HAKI HIDRIT DHE
LEKË FRAN ÇOKUT, ISH-PUNONJËS TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT,
TË VRARË NË KRYE TË DETYRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin e zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2007”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e ndihmës financiare, prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh, përkatësisht, familjes së Besnik Haki Hidrit dhe familjes së Lekë Fran Çokut, ish-punonjës të Shërbimit Informativ të Shtetit, të vrarë në krye të detyrës.

2. Ky fond përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha